الأصول الثلاثة

"Tre Themele dhe Bazat e tyre"

Nga Sheikh al-Islam
Muhammed b. Abdul-Vehhab

لا إله إلا الله



www.Thirrja-në-Teuhid.com

الأصول الثلاثة

Tre Themele dhe Bazat e tyre

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Bismil-lahir Rrahmanir Rrahim

Tre Themele dhe Bazat e tyre

Nga Sheikh al-Islam Muhammed ibn Abdul-Vehhab (Allahu e mëshiroftë).

Me Emrin e Allahut, i Gjithmëshirëshmi, Mëshirëploti.

Dije pra, Allahu të mëshiroftë, që është detyrim mbi ty që të kesh dije rreth katër çështjeve:

(1) Dija (*El-'ilm)*, që është njohja e Allahut dhe njohja e të Dërguarit ﷺ dhe njohja e fesë Islame me argumentat (faktet, provat) e saj.

(2) Të vepruarit me këtë (dije).

(3) Të thirrurit në të.

(5) Të duruarit ndaj çdo fatkeqësie apo dëmi që të bie si pasojë e kësaj.Prova për këtë është thënia e Allahuttë Lartësuar:

وَالْعَصْرِ إِنَّ الإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ

"(Betohem) për kohën! Me të vërtetë që njeriu është në humbje të plotë, Përveç atyre që besojnë (në Besimin e Pastër Islam në Një Zot) **dhe punojnë mirësi e drejtësi, edhe që e këshillojnë njëritjetrin për El-Hak** (për të vërtetën; urdhërojnë për El-Ma'ruf – që ka urdhëruar Allahu dhe ndalojnë nga El-Munker - e keqja që ka ndaluar Allahu), **edhe që e këshillojnë njëri-tjetrin të jenë të durueshëm** (nga vuajtjet, mundimet, dëmtimet që i bien njeriut nga përpjekja për Çështjen e Allahut, për të përhapur Fenë e Tij të Vërtetë të Besimit të Pastër Islam deri në Xhihad)**."**(El Asr:1-3)

Esh-Shaf'i (Allahu e mëshiroftë) tha: *"Nëse Allahu ﷻ nuk do të zbriste për krijimin e Tij asnjë argument tjetër pos këtij, (ky argument) do të qe mjaft për ta (për tu udhëzuar)."*

El-Bukhari (Allahu e mëshiroftë) tha (në Sahih el-Bukhari): *"Kapitulli: Dija paraprin të folurit dhe të vepruarit dhe prova për këtë është thënia e Allahut ﷻ:* ***"Dije pra, se padyshim La ilahe il-la Allah (Nuk ka të adhuruar tjetër të merituar pos Allahut), dhe kërko falje për gjynahin tënd dhe për besimtarët e besimtaret. Dhe Allahu di mirë për lëvizjet tuaja dhe për vendin ku qëndroni..."*** (Muhammed:19). *Pra Ai përmendi dijen përpara të folurit apo veprimit."*

Dije pra, Allahu të mëshiroftë, se është e detyrueshme për çdo Musliman, mashkull apo femër që të mësojë dhe të veprojë mbi tre çështje:

E Para: Që Allahu i Laretësuar na krijoi ne dhe na furnizoi, dhe nuk na krijoi pa qëllim, por përkundrazi Ai ﷻ dërgoi të Dërguarin e Tij ﷺ tek ne. Kështu, kush i bindet atij ﷺ do të hyjë në Xhenet dhe kush nuk e pranon dhe nuk i bindet atij ﷺ do të hyjë në Zjarr (Xhehenem) dhe provë për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

إِنَّا أَرْسَلْنَا إِلَيْكُمْ رَسُولًا شَاهِدًا عَلَيْكُمْ كَمَا أَرْسَلْنَا إِلَى فِرْعَوْنَ رَسُولًا فَعَصَى فِرْعَوْنُ الرَّسُولَ
فَأَخَذْنَاهُ أَخْذًا وَبِيلًا

"Vërtet që Ne ju kemi çuar juve (o njerëz) **të Dërguar** (Muhammedin a.s.) **për të dëshmuar mbi ju, ashtu siç çuam të Dërguar** (Musain a.s.) **te Faraoni. Por Faraoni nuk iu bind të Dërguarit, andaj Ne e mbërthyem atë me ndëshkim të ashpër."** (El Muzzemmil:15-16)

E Dyta: Allahu ﷻ nuk do që t'i përshkruhet partner Atij në adhurim, as ndonjë engjëll sado i afërt qoftë, as ndonjë i Dërguar dhe prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا

"Dhe vërtet që xhamitë janë për Allahun, kështu që mos lutni asnjë tjetër bashkë me Allahun."(El Xhin:18)

E Treta: Kush i bindet të Dërguarit ﷺ dhe njëson Allahun (veçon Allahun si Të Vetëm e pa partner duke mos i bërë shirk Allahut ﷻ) në të gjithë adhurimin e tij (me të cilin ne jemi urdhëruar) mbi Teuhid (duke e bazuar adhurimin e tij mbi faktin që s'ka zot veç Allahut dhe duke e bërë adhurimin e tij të pastër dhe të sinqertë dhe vetëm për Allahun ﷻ pa i përshkruar partner Atij), nuk i lejohet që të marrë si mbrojtës dhe aleatë ata që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin ﷺ e Tij edhe sikur këta të jenë më të afërmit e tij dhe prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَوْ كَانُوا آبَاءَهُمْ أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَشِيرَتَهُمْ أُولَئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمُ الْإِيمَانَ وَأَيَّدَهُمْ بِرُوحٍ مِنْهُ وَيُدْخِلُهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ أُولَئِكَ حِزْبُ اللَّهِ أَلَا إِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

"Ti nuk do të gjesh popull i cili beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, të bëjë miqësi me ata që i kundërvihen Allahut dhe të Dërguarit të Tij, edhe sikur ata të ishin baballarët e tyre, apo bijtë e tyre, apo vëllezërit e tyre, apo të afërmit e tyre. Për të tillët Ai ka shkruar Besimin në zemrat e tyre dhe i ka forcuar me Ruh (dritë, udhëzim të vërtetë) **nga Vetë Ai. Dhe Ne do t'i shtiem ata ndër Kopshte të Begatë nën të cilët rrjedhin lumenj për të banuar aty** (përgjithmonë).**Allahu është i Kënaqur me ta dhe ata janë** (të kënaqur) **me Të.Ata janë Pala e Allahut. Vërtet! Është Pala e Allahut që do të jenë ngadhënjyesit."** (El Muxhadilah:22)

Dije pra, Allahu të drejtoftë në bindje ndaj Tij, që feja e vërtetë dhe e drejtë, rruga e Ibrahimit ﷺ, është që ta adhurosh Allahun si Të Vetëm e pa partner duke e bërë adhurimin të pastër dhe të sinqertë e vetëm për Të. Kjo është ajo me të cilën Allahu ﷻ urdhëroi të gjithë njerëzit dhe për këtë Ai ﷻ i krijoi ata. Allahu I Lartësuar thotë:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

"Dhe Unë (Allahu) **nuk i krijova njerëzit dhe xhindet, veçse që ata duhet të më adhurojnë vetëm Mua."**(Edh Dharijat:56)

Dhe kuptimi i adhurimit këtu është të njësosh Allahun ﷻ në gjithçka me teuhid. Dhe urdhëri më i lartë që ka urdhëruar Allahu ﷻ është teuhidi që është njësimi i Allahut ﷻ në të gjithë adhurimin.

Gjëja më serioze që Ai ﷻ ka ndaluar është shirku që është t'i lutesh dikujt tjetër veç Tij (apo së bashku me Të) dhe prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَلا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا وَبِذِي الْقُرْبَى وَالْيَتَامَى وَالْمَسَاكِينِ وَالْجَارِ ذِي الْقُرْبَى وَالْجَارِ الْجُنُبِ وَالصَّاحِبِ بِالْجَنْبِ وَابْنِ السَّبِيلِ وَمَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ مَنْ كَانَ مُخْتَالًا فَخُورًا

"Adhuroni Allahun dhe mos i vini Atij shok në adhurim dhe u bëni mirësi prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve që lypin, fqinjit të afërt, fqinjit të ardhur, shokut pranë, udhëtarit (që takoni) **dhe atyre** (robërve) **që i keni nën pushtetin tuaj. Vërtet Allahu nuk i do ata që janë kryepërpjetë e që burren."** (An Nisa:36)

Pra nëse të pyesin: Cilat janë tre bazat themelore (tre principet themelore) që dikush duhet të dijë?

Thuaj: Dija e robit rreth Zotit të tij dhe fesë së Tij (Islamit) dhe të Dërguarit të Tij, Muhammedit ﷺ.

[Principi i parë: Njohja e Allahut]

Nëse të pyesin: Kush është Zoti yt? Thuaj: Zoti im është Allahu ﷻ që më ka furnizuar mua dhe gjithë krijimin me favoret dhe bekimet e Tij. Ai është Ai që unë adhuroj dhe s'ka tjetër që unë adhuroj veç Tij. Prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

"Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e Alemin-it (Zoti i të gjitha botëve, i gjithësisë dhe i gjithçkaje që gjindet në të, gjithçka që ka krijuar Allahu, Zoti i njerëzve dhe I xhindeve)." (El Fatiha:1)

Gjithçka përveç Allahut është e krijuar dhe unë jam një nga krijesat.

Nëse të pyesin: Si arrite ta njohësh Zotin tënd? Thuaj: Nëpërmjet Shenjave të Tij dhe atyre që Ai ka krijuar; dhe nga shenjat e Tij janë nata dhe dita, dielli dhe hëna; dhe nga ato që Ai ka krijuar janë shtatë qiejt dhe shtatë tokat dhe gjithçka në to dhe mes tyre.

Prova është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَمِنْ آيَاتِهِ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَهُنَّ إِنْ كُنْتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ

"Dhe nga Shenjat e Tij janë nata dhe dita edhe dielli dhe hëna. Mos u bini në sexhde (në adhurim) **as diellit e as hënës, por bini në sexhde** (në adhurim e me nënshtrim) **vetëm ndaj Allahut i Cili I krijoi ato, nëse jeni vërtet që e adhuroni Atë."** (Fusilet:37)

Dhe thënia e Allahut të Lartësuar:

إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَى عَلَى الْعَرْشِ يُغْشِي اللَّيْلَ النَّهَارَ يَطْلُبُهُ حَثِيثًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ وَالنُّجُومَ مُسَخَّرَاتٍ بِأَمْرِهِ أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ

"Vërtet që Zoti juaj është Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe tokën në Gjashtë Ditë dhe pastaj Ai Isteva (u ngrit lart e qëndroi mbi) **Arsh** (Fronin e Tij Madhështor vërtet ashtu siç i shkon Madhështisë së Tij)**. Ai sjell natën si mbulesë të ditës dhe secila duke synuar tjetrën pandërprerë; dhe Ai krijoi edhe diellin, edhe hënën, edhe yjet të nënshtruar ndaj Urdhërit të Tij. Padyshim që i Tij është Krijimi dhe Komandimi. I Shenjtëruar dhe i Lartësuar qoftë Allahu, Zoti i Aleminit** (i gjithë botëve, i gjithçkaje që ekziston, injerëzve dhe i xhindeve)**."** (Al A'raf:54)

Zoti është Ai që adhurohet dhe prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ

"O njerëz! Adhuroni Allahun, Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të bëheni të përkushtuar (Et- Muttekunë). **I Cili e ka bërë tokën vend pushimi për ju dhe qiellin me kupë si mbulesë duke dërguar që andej ujë për të prodhuar fruta si furnizim për ju. Atëherë pra, mos i vini shokë Allahut** (në adhurim) **kur ju e dini** (se vetëm Ai ka të drejtë të adhurohet e askush tjetër).**"** (El Bekare:21-22)

Ibn Kethir (Allahu e mëshiroftë) thotë: *"Krijuesi i këtyre gjërave është I Vetmi që meriton (të adhurohet) dhe që duhet adhuruar."*

Llojet e adhurimit që Allahu ka urdhëruar janë: Islami (nënshtrimi dhe bindja ndaj Allahut të Lartësuar), imani (besimi i zemrës i shoqëruar me fjalët dhe veprat) dhe ihsani (adhurimi perfekt) dhe nga këto është duaja, frikë-respekti (*khauf*), shpresa (*raxha´a*) dhe mbështetja (*tavekul*), të dëshiruarit me ngulmim (*raghbah*), të frikësuarit (*rahbah*), respekti dhe përulja (*khushu'*), kujdesi (*khashjah*), të kthyerit me pendim (*inaabah*), të kërkuarit ndihmë (*isti'anah*), të kërkuarit strehim (*isti'adhah*), të kërkuarit lirim dhe shpëtim (*istighathah*), kurbani (*dhabh*), betimet (*nadhr*) dhe pjesa tjetër e adhurimit e urdhëruar nga Allahu ﷻ. Të gjitha këto duhen bërë absolutisht vetëm për Allahun e Lartësuar.

Prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا

"Dhe vërtet që xhamitë janë për Allahun, kështu që mos lutni asnjë tjetër bashkë me Allahun." (El Xhin:18)

Kushdo që drejton ndonjë pjesë të tij (adhurimit) ndaj dikujt apo diçkaje veç Allahut të Lartësuar, është *mushrik* (idhujtar) *kafir* dhe provë për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ فَإِنَّمَا حِسَابُهُ عِنْدَ رَبِّهِ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الْكَافِرُونَ

"Dhe kushdo që lut (ose adhuron) **në vend të Allahut çdo ilah** (zot) **tjetër për të cilin nuk ka asnjë provë, atëherë llogaria e tij është vetëm te Zoti i tij. Vërtet që Kafirët** (mohuesit e Njësisë së Allahut) **nuk do të kanë kurrë sukses."** (El Mu'minun:117)

Në hadith thuhet: *"Duaja është qendra (esenca) e adhurimit"* dhe prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَقَالَ رَبُّكُمُ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ

"Dhe Zoti juaj thotë: "M'u lutni Mua, Unë do t'ju përgjigjem. Me të vërtetë se ata të cilët e përbuzin adhurimin ndaj Meje, ata padyshim që do të hyjnë në Xhehenem me poshtërim!" (Gafir:60)

Prova për frikë-respektin (*khauf*) është thënia e Allahut të Lartësuar:

إِنَّمَا ذَلِكُمُ الشَّيْطَانُ يُخَوِّفُ أَوْلِيَاءَهُ فَلَا تَخَافُوهُمْ وَخَافُونِ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ

"Vetëm Shejtani jua shtie në mendje frikën e Eulijave të tij (të shokëve, pasuesve të tij si mosbesimtarët, paganët, mohuesit etj)**, kështu që mos iu frikësoni atyre aspak, por m'u frikësoni vetëm Mua, nëse jeni besimtarë të vërtetë."**(Al Imran:175)

Prova për shpresën (*raxha)* është thënia e Allahut të Lartësuar:

قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِثْلُكُمْ يُوحَى إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَٰهُكُمْ إِلَٰهٌ وَاحِدٌ فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا

"Thuaj (O Muhammed): **"Unë jam vetëm një njeri si edhe ju,** (por) **mua më është frymëzuar e më është shpallur se i adhuruari juaj është Një i Adhuruar i Vetëm, Allahu; kështu pra, kushdo që shpreson për Takimin me Zotin e tij, le të punojë mirësi e drejtësi dhe të mos i bashkojë askënd për shok në adhurim Zotit të tij."** (El Kehf:110)

Prova për mbështetjen (*tavekul)* është thënia e Allahut të Lartësuar:

قَالَ رَجُلَانِ مِنَ الَّذِينَ يَخَافُونَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمَا ادْخُلُوا عَلَيْهِمُ الْبَابَ فَإِذَا دَخَلْتُمُوهُ فَإِنَّكُمْ غَالِبُونَ وَعَلَى اللَّهِ فَتَوَكَّلُوا إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ

"Dy burra prej atyre të cilët e kishin frikë Allahun dhe të cilëve Allahu u kishte dhuruar Mirësinë e Tij (ata të dy ishin Jusha dhe Kaleb) **thanë: "I sulmoni nga porta, sepse kur ju të hyni brenda, fitorja do të jetë e juaja dhe vini shpresat tuaja vetëm tek Allahu, nëse jeni besimtarë të vërtetë."** (El Maideh:23)

Dhe Ai ﷻ thotë:

وَيَرْزُقْهُ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ إِنَّ اللَّهَ بَالِغُ أَمْرِهِ قَدْ جَعَلَ اللَّهُ لِكُلِّ شَيْءٍ قَدْرًا

"Dhe Ai do t'i sjellë atij Rizk (furnizim e të mira) **prej nga ai as nuk mund ta mendonte. Dhe kushdo që mbështetet e vë shpresat tek Allahu, atëherë Ai do t'i mjaftojë atij plotësisht. Padyshim që Allahu do t'ia përmbushë qëllimin atij. Sigurisht që Allahu ka vendosur masë për çdo gjë."** (Et Talak:3)

Prova për të dëshiruarit me ngulmim (*raghbah*), të frikësuarit (*rahbah*), respektit dhe përuljes (*khushu´u*), është thënia e Allahut të Lartësuar:

فَاسْتَجَبْنَا لَهُ وَوَهَبْنَا لَهُ يَحْيَى وَأَصْلَحْنَا لَهُ زَوْجَهُ إِنَّهُمْ كَانُوا يُسَارِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا وَكَانُوا لَنَا خَاشِعِينَ

"Kështu Ne iu përgjigjëm thirrjes së tij dhe Ne i dhuruam atij Jahjanë duke ia shëruar bashkëshorten (për të lindur fëmijë) **për të. Ata vërtet që ishin që nxitonin të bënin punë të mira dhe gjithnjë na luteshin Neve me shpresë dhe frikë dhe gjithnjë nënshtroheshin ndaj Nesh"** (El Enbija':90)

Prova për kujdesin dhe frika (*khashjah*), është thënia e Allahut të Lartësuar:

فَلَا تَخْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنِ

"Pra mos jua ki frikën atyre por mu frikësoni Mua." (El Maideh:3)

Prova për të kthyerit me pendim (*inaabah*), është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَأَنِيبُوا إِلَى رَبِّكُمْ وَأَسْلِمُوا لَهُ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَكُمُ الْعَذَابُ ثُمَّ لَا تُنْصَرُونَ

"Dhe kthehuni me pendim e përkushtim me Besim të vërtetë tek Zoti juaj dhe nënshtrojuni Atij në Islam si muslimanë, para se t'ju vijë ndëshkimi, (sepse) **atëherë nuk do të ndihmoheni."** (Ez Zumer:54)

Prova për të kërkuarit ndihmë (*isti'anah*), është thënia e Allahut të Lartësuar:

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë (kudo, në çdo kohë dhe për çdo gjë)."(El Fatiha:5)

Dhe në hadith thuhet: *"Nëse kërkoni ndihmë, kërkoni ndihmë nga Allahu."(Tirmidhi)*

Prova për të kërkuarit strehim (*isti'adhah*), është thënia e Allahut të Lartësuar:

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ

"Thuaj: "I mbështetem (Allahut) **Zotit të agimit** (të më ruajë)." (El Felek:1)

Dhe:

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ

"Thuaj: "I mbështetem (Allahut) **Zotit të njerëzve."** (En Nas:1)

Prova për të kërkuarit lirim dhe shpëtim (*istighathah*), është thënia e Allahut të Lartësuar:

إِذْ تَسْتَغِيثُونَ رَبَّكُمْ فَاسْتَجَابَ لَكُمْ أَنِّي مُمِدُّكُمْ بِأَلْفٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ مُرْدِفِينَ

"(Përkujtoni) **kur ju kërkuat ndihmë te Zotit tuaj dhe Ai u përgjigj** (duke ju thënë)**: "Do t'ju ndihmoj me njëmijë melekë radhëradhë."** (El Enfal:9)

Prova për kurbanin (*dhabh*) është thënia e Allahut të Lartësuar:

قُلْ إِنَّ صَلاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ لَا شَرِيكَ لَهُ وَبِذَلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا أَوَّلُ الْمُسْلِمِينَ

"Thuaj: "Sigurisht falja ime, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e Aleminit (njerëzve, xhindeve dhe gjithçkaje që ekziston)**. Ai nuk ka asnjë shok e të barabartë me Të dhe për këtë unë jam urdhëruar dhe unë jam i pari që I nënshtrohem Vullnetit të Tij si Musliman."** (Enaam:162-163)

Gjithashtu Resuli ﷺ tha: *"Allahu ka mallkuar këdo që bën kurban për dikë (apo diçka) tjetër veç Allahut ﷻ."* [1]

Prova për betimet (*nadhr*), është thënia e Allahut të Lartësuar:

يُوفُونَ بِالنَّذْرِ وَيَخَافُونَ يَوْمًا كَانَ شَرُّهُ مُسْتَطِيرًا

"Ata (janë të cilët) **përmbushin betimet** (e tyre) **dhe i frikësohen një Dite, e keqja e së cilës ka përmasa të mëdha."**(El Insan:7)

[1] *Transmeton imam Muslim.*

[Principi i dytë]

Dija rreth fesë së Islamit me prova, që është t'i nënshtrohesh Allahut të Lartësuar me Teuhid dhe (të nënshtrohesh) me bindje ndaj Tij dhe të pastrohesh dhe të distancohesh nga shirku dhe mushrikët. Kjo është në tre nivele: Islam, iman dhe ihsan. Çdo nivel ka shtyllat e tij.

Niveli i parë: Shtyllat e Islamit janë pesë:

(1) Të dëshmuarit se s'ka Zot veç Allahut të Lartësuar i cili meriton të adhurohet, dhe të dëshmuarit se Muhammedi ﷺ është i Dërguari i Allahut.

(2) Të falurit e Namazit.

(3) Të dhënit e Zekatës.

(4) Të agjëruarit e Ramazanit.

(5) Të kryerit e Haxhit.

Prova për Shehadetin është thënia e Allahut të Lartësuar:

شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

"Allahu dëshmon se La Ilahe il-la Huve (nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Atij)**;** (dëshmojnë) **edhe melekët, edhe ata që kanë mend e që dinë; Ai e mban Krijimin e Tij në Drejtësi të plotë. La Ilahe il-la Huve** (askush nuk ka të drejtë, nuk meriton e nuk duhet të adhurohet përveç Atij)**, I Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues."** (Al Imran:18)

Kuptimi i shehadetit është se askush s'ka të drejtë të adhurohet veç Allahut: *"LA ILAHA"*, mohon gjithçha që adhurohet veç Allahut dhe *"IL-LA ALLAH"* përcakton adhurimin vetëm për Allahun ﷻ pa i përshkruar partner në adhurimin e Tij, sikurse (fakti se) Ai nuk ka partner në Pushtetin dhe Sundimin e Tij ﷻ. Shpjegimi që e qartëson këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ إِنَّنِي بَرَاءٌ مِمَّا تَعْبُدُونَ إِلَّا الَّذِي فَطَرَنِي فَإِنَّهُ سَيَهْدِينِ وَجَعَلَهَا كَلِمَةً بَاقِيَةً فِي عَقِبِهِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ

"Dhe (kujto) **kur Ibrahimi i tha babait të tij dhe popullit të tij: "Me të vërtetë që unë jam i pafajshëm nga çfarë ju adhuroni, Në vend të Atij i Cili më krijoi mua dhe padyshim që Ai do të më udhëzojë mua." Dhe ai** (Ibrahimi) **e bëri atë** (Fjalën La ilahe il-la Allah - nuk ka tjetër të adhuruar të merituar përveç Allahut Një e të Vetëm) **Fjalë të jetonte ndër pasardhësit e tij, që ata të mund të riktheheshin** (me pendim tek Allahu ose të merrnin mësim)." (Ez Zukhruf:26-28)

Dhe thënia e Tij ﷻ:

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا
يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِنْ دُونِ اللَّهِ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُولُوا اشْهَدُوا بِأَنَّا مُسْلِمُونَ

"Thuaj (O Muhammed)**: "O ithtarë të Librave të Parë!** (jehudi e të krishterë)**: Ejani te një fjalë që është e drejtë dhe e përbashkët mes nesh dhe jush: që të mos adhurojmë askënd përveç Allahut, që të mos i vëmë shokë Atij në adhurim dhe që asnjë prej nesh të mos marrë të tjerë për zot përveç Vetëm Allahut." Pastaj në qoftë se ata largohen, thuaju: "Dëshmoni për ne se jemi muslimanë** (besimdrejtë)**."** (Al Imran: 64)

Prova për të dëshmuarit se Muhammedi ﷺ është i Dërguari i Allahut, është thënia e Allahut të Lartësuar:

لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ

"Vërtet që ju ka ardhur juve një i Dërguar (Muhammedi) **nga vetë ju** (të cilin ju e njihni fare mirë). **Ai pikëllohet nëse juve ju bie ndonjë lëndim e vështirësi. Ai** (Muhammedi) **është I merakosur dhe i dëshiruar për ju** (që të jeni të udhëzuar drejt dhe t'i pendoheni Allahut, me qëllim që të mund të fitoni Xhennetin e të shpëtoni prej Zjarrit të Xhehenemit) **dhe për besimtarët ai është që ndjen shumë, mëshirues."** (Teube:128)

Kuptimi i të dëshmuarit se Muhammedi ﷺ është i Dërguari i Allahut, është që ti bindesh atij në çdo gjë që ai ﷺ komandon. Të besosh gjithçka që ai na ka informuar. Të qendrosh larg gjithçkaje që ai ka ndaluar apo qortuar dhe të adhurosh Allahun vetëm siç e ka përshkruar ai (Muhammedi ﷺ). Prova për namazin, zekatën dhe shpjegimin e teuhidit është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَمَا أُمِرُوا إِلاَّ لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ

"Dhe ata nuk u urdhëruan për tjetër, pos asaj që duheshin të adhuronin vetëm Allahun dhe të mos adhuronin tjetër përveç a përkrah Tij, të adhuronin Atë me besim të vërtetë e me përkushtim të plotë, edhe të kryenin faljen e detyruar të namazit (Ikametus-salat) **e të jepnin Zekatin: dhe kjo është feja e drejtë, e vërtetë."** (El Bejjineh:5)

Prova për agjërimin është thënia e Allahut të Lartësuar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آَمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

"O ju që keni besuar! Ju është urdhëruar juve edhe Es-Seum (agjërimi) **siç u qe urdhëruar edhe atyre përpara jush me qëllim që të mund të bëheni El-Muttekunë** (të përkushtuar)**."** (El Bekare:183)

Prova për Haxh është thënia e Allahut të Lartësuar:

فِيهِ آَيَاتٌ بَيِّنَاتٌ مَقَامُ إِبْرَاهِيمَ وَمَنْ دَخَلَهُ كَانَ آَمِنًا وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا وَمَنْ كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ

"Në të ka shenja të qarta, (si për shembull:) **Mekami i Ibrahimit** (vendqëndrimi i Ibrahimit)**; kushdo që hyn në të** (Ka'abë) **fiton sigurinë. Dhe Haxhi** (Udhëtimi për të vizituar Ka'abën) **është një detyrë që njerëzit i detyrohen Allahut për ta kryer, ata të cilët munden të përballojnë shpenzimet. Dhe kushdo që nuk beson , benë kufr** (mohon Haxhin si shtyllë të Islamit)**, atëherë Allahu është më I Pasuri, nuk ka nevojë për askënd në Alemin** (ndër njerëz, ndër xhinde, ose në mbarë gjithësinë. Ai është Krijuesi i saj). (Al-Imran:97)

[Niveli i dytë]

Imani që ka shtatëdhjetë e më tepër degë, më e larta e së cilave është ""**La ilahe il-laAll-llah" -** *(Askush nuk meriton, nuk ka të drejtë e nuk duhet të adhurohet përveç All-llahut!)* dhe më e ulëta është të largosh diçka që shkakton dëm, nga rruga dhe *"el-haja"* (ndrojtja) është degë e imanit. Gjashtë shtyllat e tij janë:

(1) Besimi në Allah.
(2) Në engjëjt e Tij.
(3) Në librat e Tij.
(4) Në të dërguarit e Tij.
(5) Në ditën e fundit.
(6) Besimi i në *"Kader"* qoftë e mirë apo e keqe.

Prova për këto gjashtë shtylla është thënia e Allahut të Lartësuar:

لَيْسَ الْبِرَّ أَنْ تُوَلُّوا وُجُوهَكُمْ قِبَلَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَلَكِنَّ الْبِرَّ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآَخِرِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالْكِتَابِ وَالنَّبِيِّينَ وَآَتَى الْمَالَ عَلَى حُبِّهِ ذَوِي الْقُرْبَى وَالْيَتَامَى وَالْمَسَاكِينَ وَابْنَ السَّبِيلِ وَالسَّائِلِينَ وَفِي الرِّقَابِ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ وَآَتَى الزَّكَاةَ وَالْمُوفُونَ بِعَهْدِهِمْ إِذَا عَاهَدُوا وَالصَّابِرِينَ فِي الْبَأْسَاءِ وَالضَّرَّاءِ وَحِينَ الْبَأْسِ أُولَئِكَ الَّذِينَ صَدَقُوا وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُتَّقُونَ

"Nuk është El-Bir (përkushtim, drejtësi dhe çdo lloj veprimi tjetër në bindje ndaj Allahut) **se ju e ktheni fytyrën tuaj drejt lindjes dhe** (apo) **perëndimit** (në falje), **por El-Bir është** (cilësi e atij) **i cili beson në Allahun, në Ditën e Fundit, në Melekët, në Librin, në Pejgambrët dhe u jep pasurinë e tij, pavarësisht nga dashuria për të, të afërmve, jetimëve, të varfërve, endacakut dhe kujtdo që kërkon,** (e jep edhe) **për të liruar robët, kryen faljen e namazit dhe jep Zekatin, të cilët përmbushin premtimin kur e japin atë, të cilët janë të duruar në varfëri të thellë, në sëmundje, si edhe në kohën e luftimit** (në fushën e betejës). **Këta janë njerëzit e së vërtetës dhe këta janë El-Muttekunët** (të përkushtuarit në Besimin e Pastër Islam)." (El Bekare:177)

Prova për Kaderin është thënia e Allahut të Lartësuar:

إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ

"Me të vërtetë që Ne e kemi krijuar çdo gjë me Kader (Paracaktimi Hyjnor i të gjitha gjërave para krijimit të tyre, shkruar në Librin e Ruajtur Hyjnor të Vendimeve për çdo ndodhi të çdo gjëje - El- Leuh El-Mahfudh)." (El Kamar:49)

[Niveli i tretë]

Ihsani ka një shtyllë e vetme që konsiston në të adhuruarit e Allahut të Lartësuar, njëlloj sikur ta shohësh Atë pasi edhe nëse ti nuk e sheh Atë patjetër që Ai të sheh ty. Prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ اتَّقَوْا وَالَّذِينَ هُمْ مُحْسِنُونَ

"(Sepse) **sigurisht që Allahu është me ata që i frikësohen Atij (duke i përmbushur detyrimet ndaj Tij) dhe që janë Muhsinunë** (mirëpunues në Rrugë të Allahut)**."**
(En Nahl:128)

Dhe thënia e Tij ﷻ:

وَتَوَكَّلْ عَلَى الْعَزِيزِ الرَّحِيمِ الَّذِي يَرَاكَ حِينَ تَقُومُ وَتَقَلُّبَكَ فِي السَّاجِدِينَ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

" Dhe mbështetu e vari shpresat tek i Gjithëfuqishmi, Mëshirëploti. I Cili të sheh ty (O Muhammed) **kur ti ngrihesh** (vetëm, natën për faljen e Tahaxhud-it: falje jo e detyruar pas mesit të natës). **Dhe lëvizjet e tua në mesin e atyre që bien në sexhde** (në faljen e përbashkët në Xhami). **Vërtet që Ai, vetëm Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri. "**
(Esh Shuara:217-220)

Dhe thënia e Tij ﷻ:

وَمَا تَكُونُ فِي شَأْنٍ وَمَا تَتْلُو مِنْهُ مِنْ قُرْآنٍ وَلَا تَعْمَلُونَ مِنْ عَمَلٍ إِلَّا كُنَّا عَلَيْكُمْ شُهُودًا إِذْ تُفِيضُونَ فِيهِ وَمَا يَعْزُبُ عَنْ رَبِّكَ مِنْ مِثْقَالِ ذَرَّةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ وَلَا أَصْغَرَ مِنْ ذَلِكَ وَلَا أَكْبَرَ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ

"As ti (O Muhammed) **nuk bën ndonjë vepër, as nuk këndon ndonjë pjesë nga Kur'ani dhe as ju** (njerëz) **nuk bëni ndonjë vepër** (të mirë ose të keqe)**, veçse Ne jemi Dëshmues mbi ju kur ju e kryeni atë. Dhe asgjë nuk i fshihet Zotit tënd qoftë sa një atom në tokë a në qiell qoftë. Dhe as çfarë është më e vogël se ajo dhe as çfarë është më e madhe, veçse shkruhet në Librin e Qartë.[2]"** (Junus:61)

Prova nga suneti është hadithi i mirënjohur i Xhibriilit i trasmetuar nga Umari ﷺ që tha:

"Një ditë kur po rrinim me Resulullahin (ﷺ), erdhi tek ne një njeri me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zeza. Tek ai nuk vëreheshin shenja udhëtimi e asnjëri nga ne nuk e njihte atë. Ai erdhi e u ul me Resulin duke bashkuar gjunjët e tij me gjunjët e Resulit dhe shuplakat e tij mbi kofshët e tij dhe tha: "O Muhammed! Më informo për islamin!" Resuli tha: "Islami është që të dëshmosh se s'ka zot veç Allahut qe meriton te adhurohet dhe Muhammedi është i dërguari i Allahut; të falësh namazin; të japësh zekatën; të agjërosh Ramadanin dhe të kryesh Haxhin nëse ke mundësi." Ai tha: "Ke thënë të vërtetën!" Ne u mahnitëm se si ai i drejtonte (Resulit) pyetjen dhe pastaj thonte që ai (Resuli) kishte thënë të vërtetën. Ai tha: "Më informo për imanin!" Ai (Resuli) tha: "Është të besosh në Allah; në engjëjt e Tij; në librat e Tij; në Derguarit e Tij; në diten e fundit (gjykimit - akhiret); dhe që të besosh në kader qoftë i mirë apo i keq." Ai tha: "Ke thënë të vërtetën!" Ai tha: "Më informo për ihsanin!" Ai (Resuli) tha: "Të adhurosh Allahun njëlloj sikur e shikon Atë pasi edhe ti nuk e sheh Atë patjetër që Ai të sheh ty." Ai tha: "Më informo për orën e fundit!" Ai (Resuli) tha: "Ai që pyetet nuk e di më mirë se ai që pyet." Ai tha: "Atëherë më informo rreth shenjave të saj!" Ai (Resuli) tha: "Që skllavja (rrobëresha) do të lindë pronaren e saj; kur të shohësh barinjtë e zbathur e të zhveshur që të bëjnë gara në ndërtesa të larta." Umari tha se ai (pyetësi) u largua dhe pas pak kohe ai (Resuli) pyeti: "O Umar, a e di se kush ishte pyetësi? Unë u përgjigja: "Allahu dhe i Dërguari i tij e dinë më mirë." Ai (Resuli) tha: "Ai ishte Xhibriili dhe erdhi tu mësojë ju fenë tuaj."

[2] Tefsir At-Tabari.

[Principi i tretë]

Dija rreth të dërguarit të Allahut të Lartësuar, Muhammedit ﷺ dhe ai ishte; Muhammed ibn Abdullah ibn Abdul-Muttalib ibn Hashim; dhe Hashim ishte nga Kurejshët; Kurejshët ishin nga arabët dhe arabët nga Ismaili عليه السلام i biri i Ibrahimit عليه السلام*Khalili* (i Allahut) paqja dhe mëshira më e shkëlqyer qoftë mbi të dhe mbi Resulin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

Ai (Resuli ﷺ jetoi 63-vite, 40-vite para se të ishte i Dërguar dhe 23-vite si Resul dhe Nebi. Ai u dërgua si Nebi me Ikra (fillimin e sures El-Alak) dhe si Resul me suren Muddeththir. Toka e tij qe Meka dhe emigroi në Medinah. Allahu i Lartësuar e dërgoi atë paralajmërues ndaj Shirkut dhe të përgëzonte dhe thërriste në Teuhid. Prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

يَاأَيُّهَا الْمُدَّثِّرُ قُمْ فَأَنْذِرْ وَرَبَّكَ فَكَبِّرْ وَثِيَابَكَ فَطَهِّرْ وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ وَلَا تَمْنُنْ تَسْتَكْثِرُ وَلِرَبِّكَ فَاصْبِرْ

"O ti (Muhammed) **i mbështjellur në rroba! Ngrihu dhe këshillo! Dhe madhëroje Zotin tënd! Dhe rrobat e tua i pastro! Dhe larg nga Er-Ruxhz** (idhujt) **qëndro! Dhe mos jep** (me qëllim) **për të marrë më shumë! Dhe për hir të Zotit tënd, duro!"** (El Muddethir:1-7)

Kuptimi i *"Ngrihu dhe paralajmëro njerëzit"* është që tu tërheqë vërejtjen ndaj shirkut dhe të thirrë në teuhid; *"dhe adhuro Zotin tënd"* do të thotë adhuroje Atë me teuhid; *"pastro vehten tënde, rrobat dhe veprat e tua"* do të thotë pastro vehten nga Shirku; *"qëndro larg idhujve"*, er-ruxhz do të thotë idhujt dhe haxhr do të thotë qëndroju larg atyre e mos iu afro atyre apo mushrikëve.

Ai ﷺ e kreu këtë detyrë për dhjetë vite duke thirrur në Teuhid dhe pas dhjetë vitesh ai u ngrit në qiej (miraxh) dhe pesë kohët e namazit u bënë të detyrueshme për të dhe Ai u fal në Mekë për tre vite dhe pastaj u urdhërua të bëjë Hixhra (të emigrojë) në Medinah. Hixhrah është të emigrosh nga tokat e shirkut në toka Islame. Hixhrah nga tokat e shirkut në tokat Islame është detyrim mbi muslimanët dhe vazhdon deri orën e fundit dhe provë për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

إِنَّ الَّذِينَ تَوَفَّاهُمُ الْمَلَائِكَةُ ظَالِمِي أَنْفُسِهِمْ قَالُوا فِيمَ كُنْتُمْ قَالُوا كُنَّا مُسْتَضْعَفِينَ فِي الْأَرْضِ قَالُوا أَلَمْ تَكُنْ أَرْضُ اللَّهِ وَاسِعَةً فَتُهَاجِرُوا فِيهَا فَأُولَئِكَ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ وَسَاءَتْ مَصِيرًا إِلَّا الْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ الرِّجَالِ وَالنِّسَاءِ وَالْوِلْدَانِ لَا يَسْتَطِيعُونَ حِيلَةً وَلَا يَهْتَدُونَ سَبِيلًا فَأُولَئِكَ عَسَى اللَّهُ أَنْ يَعْفُوَ عَنْهُمْ وَكَانَ اللَّهُ عَفُوًّا غَفُورًا

"Sigurisht për ata të cilët melekët i marrin në vdekje ndërkohë që po i bënin padrejtësi vetvetes së tyre duke qëndruar me jobesimtarët, në një kohë kur shpërngulja ishte e detyrueshme për ta, ata (melekët) **u thonë: "Në çfarë gjendje ishit?" Ata përgjigjen: "Ne ishim të dobët dhe të shtypur në tokë." Melekët u thonë: "A nuk ishte toka e Allahut e gjerë dhe e mjaftueshme përju për t'u shpërngulur në të?" Njerëz të tillë do ta gjejnë vendbanimin e tyre në Xhehenem. Sa përfundim i keq!" Përveç të dobtëve, burra, gra dhe fëmijë, të cilët nuk mund të mendojnë ndonjë rrugëdalje dhe nuk janë në gjendje të drejtohen në rrugën e tyre. Për këta ka shpresë se Allahu do t'i falë. Dhe Allahu është kurdoherë Falës, gjithnjë Falës i Madh."** (An Nisa:97-99)

Po ashtu thënia e Allahut të Lartësuar:

يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّ أَرْضِي وَاسِعَةٌ فَإِيَّايَ فَاعْبُدُونِ

"O robërit e Mi që më besoni! Vërtet që toka Ime është e gjerë. Më adhuroni pra Mua (Një e të Vetëm)**."**(El Ankebut:56)

El-Baghavi (Allahu e mëshiroftë) thotë: *"Ky ajet zbriti për muslimanët e Mekës që nuk bënë hixhra. Allahu iu drejtua atyre me titullin e Imanit."*

Prova nga suneti për hixhra është thënia e Rresulit ﷺ: *"Hixhra nuk merr fund derisa pendimi të marrë fund dhe pendimi nuk merr fund derisa dielli të lindë nga perëndimi."*

Kur u vendos në Medinah ai urdhëroi pjesën tjetër të obligimeve Islame si: zekatë, salatë, haxh, xhihad, ezanin, urdhërimin në të mirën dhe të ndaluarit e së keqes dhe pjesën tjetër të detyrimeve Islame. Ai i kushtoi dhjetë vite duke i stabilizuar ato dhe më pas ndërroi jetë, paqja dhe bekimet më të mira të Allahut qofshin mbi të. Ai ndërroi jetë por feja e tij mbetet. Dhe kjo (fe e jona, Islami) është feja e tij. Nuk ka të mirë veç se ai e udhëzoi umetin e tij tek ajo dhe nuk ka të keqe veçse ai e paralajmëroi umetin e tij nga ajo (në mënyrën më të mirë dhe më të plotë e perfekte të pastër nga çdo mangësi apo defekt). Kështu e mira tek e cila ai na thirri është Teuhidi dhe gjithçka që Allahu do dhe me të cilën Ai është i

kënaqur dhe e keqja nga e cila ai na paralajmëroi është shirku dhe gjithçka që Allahu urren dhe qorton. Allahu i Lartësuar e dërgoi atë të Dërguar tek të gjithë njerëzit dhe Allahu i Lartësuar e bëri të detyrueshme për të gjithë njerëzit dhe xhinët që ti binden atij.

Prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ يُحْيِي وَيُمِيتُ فَآمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ النَّبِيِّ الْأُمِّيِّ الَّذِي يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَكَلِمَاتِهِ وَاتَّبِعُوهُ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ

"Thuaj (O Muhammed): **"O njerëz! Vërtet që unë jam sjellë tek ju të gjithë si i Dërguar i Allahut - të Cilit i takon mbisundimi i qiejve dhe i tokës. La ilahe il-la Huve** (askush nuk ka të drejtë, nuk meriton e nuk duhët të adhurohet përveç Atij). **Është Ai që jep jetë dhe sjell vdekjen. Kështu pra, besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Pejgamberin që nuk di shkrimas këndim, i cili beson në Allahun dhe në Fjalët e Tij** (Kur'anin, Teuratin, Inxhilin) **dhe ndiqeni pra atë që të mund të jeni të udhëzuar."**
(Al A'raf:158)

Nëpërmjet tij ﷺ, Allahu i Lartësuar plotësoi dhe perfeksionoi fenë dhe prova është thënia e Allahut të Lartësuar:

الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا

"Sot e kam përsosur fenë tuaj dhe kam perfeksionuar favorin Tim ndaj jush dhe Jam i kënaqur me Islamin si fenë tuaj." (El Maideh:3)

Prova se Rresuli ﷺvdiq është thënia e Allahut të Lartësuar:

إِنَّكَ مَيِّتٌ وَإِنَّهُمْ مَيِّتُونَ ثُمَّ إِنَّكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عِنْدَ رَبِّكُمْ تَخْتَصِمُونَ

"Sigurisht që ti (O Muhammed) **do të vdesësh dhe padyshim që edhe ata do të vdesin, Pastaj Ditën e Ringjalljes, para Zotit tuaj ju do të haheni (debatoni) e do të kundërshtoheni mes njëri-tjetrit."** (Ez Zumer:30-31)

Pas vdekjes njerëzit do të ringjallen dhe provë për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

مِنْهَا خَلَقْنَاكُمْ وَفِيهَا نُعِيدُكُمْ وَمِنْهَا نُخْرِجُكُمْ تَارَةً أُخْرَى

"Prej saj (tokës) **Ne ju kemi krijuardhe në të do t'ju kthejmë judhe prej saj Ne do t'ju nxjerrim ju përsëri edhe një herë tjetër."** (Ta-Ha:55)

Po ashtu thënia e Allahut të Lartësuar:

وَاللَّهُ أَنْبَتَكُمْ مِنَ الْأَرْضِ نَبَاتًا ثُمَّ يُعِيدُكُمْ فِيهَا وَيُخْرِجُكُمْ إِخْرَاجًا

"Dhe Allahu ju ka nxjerrë prej (dheut të) **tokës [3] Pastaj Ai do t'ju kthejë në të** (në tokë) **dhe do t'ju nxjerrë prej saj** (përsëri në Ditën e Ringjalljes)**."** (Nuh:17-18)

Pas ringjalljes njerëzit do të merren në llogari dhe do të shpërblehen ose ndëshkohen sipas veprave të tyre.

Prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ لِيَجْزِيَ الَّذِينَ أَسَاءُوا بِمَا عَمِلُوا وَيَجْزِيَ الَّذِينَ أَحْسَنُوا بِالْحُسْنَى

"Dhe Allahut i përkasin gjithë ç'është në qiej dhe gjithë ç'është në tokë, që Ai të shpërblejë ata që kanë bërë të këqen me atë që ata kanë bërë dhe që Ai t'i shpërblejë ata që bëjnë mirë me më të mirën." (En Nexhm:31)

Dhe kush mohon ringjalljen është kafir dhe provë për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

زَعَمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ لَنْ يُبْعَثُوا قُلْ بَلَى وَرَبِّي لَتُبْعَثُنَّ ثُمَّ لَتُنَبَّؤُنَّ بِمَا عَمِلْتُمْ وَذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ

"Ata që nuk besuan, mendojnë se kurrë më nuk do të ringjallen. Thuaju: "Po! Për Zotin tim! Ju padyshim që do të ringjalleni, pastaj ju do të njoftoheni për ç'farë punuat dhe kjo është mjaft e lehtë për Allahun." (Et Tagabun:7)

[3] Tefsir At-Tabari.

Allahu i Lartësuar i solli të dërguarit e Tij si përgëzues dhe paralajmërues dhe prova për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

رُسُلًا مُبَشِّرِينَ وَمُنْذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا

"Të Dërguar si përgëzues dhe si paralajmërues në mënyrë që njerëzimi të mos ketë më arsye për t'u shfajësuar ndaj Allahut pas të Dërguarve. Dhe Allahu është kurdoherë i Gjithëfuqishëm, më i Urti Gjithëgjykues" (An Nisa :165)

I pari i tyre qe Nuhu ﷺ dhe i fundit qe Muhammedi ﷺ dhe prova është thënia e Allahut të Lartësuar:

إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّينَ مِنْ بَعْدِهِ وَأَوْحَيْنَا إِلَى إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطِ وَعِيسَى وَأَيُّوبَ وَيُونُسَ وَهَارُونَ وَسُلَيْمَانَ وَآتَيْنَا دَاوُودَ زَبُورًا

"Vërtet, Ne të kemi frymëzuar ty (O Muhammed)**, siç frymëzuam Nuhin dhe Pejgamberët pas tij.Ne gjithashtu frymëzuam Ibrahimin, Ismailin, Is'hakun, Jakubin dhe Al-Asbat** (dymbëdhjetë bijtë e Jakubit), **Isain, Ejubin, Junusin, Harunin dhe Sulejmanin.Dhe Daudit Ne i dhamë Zeburin."**(An Nisa:163)

Allahu i Lartësuar dërgoi të dërguar tek çdo komb nga Nuhu ﷺ deri tek Muhammedi ﷺ duke urdhëruar adhurimin e Allahut me Teuhid dhe duke ndaluar adhurimin e taghutit. Provë për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ فَمِنْهُمْ مَنْ هَدَى اللَّهُ وَمِنْهُمْ مَنْ حَقَّتْ عَلَيْهِ الضَّلَالَةُ فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانْظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكَذِّبِينَ

"Dhe me të vërtetë që Ne kemi dërguar te çdo Ummet (bashkësi njerëzish, popull, komb) **të Dërguar** (duke shpallur): **"Adhuroni vetëm Allahun dhe shmanguni dhe i rrini larg Tagutit** (shejtanëve ose çdo gjëje tjetër që adhurohet pos Allahut)**." Pastaj, pati prej atyre popujve të cilët Allahu i drejtoi, pati edhe të tjerë të cilët e merituan dhe iu bë e pashmangshme rruga e gabuar. Udhëtoni pra nëpër tokë dhe shikoni se si ishte fundi i atyre të cilëtpërgënjeshtruan** (të vërtetën)**."** (En Nahl:36)

Allahu i Lartësuar e bëri të detyrueshme mbi gjithë robët e Tij që të bëjnë kufr ndaj taghutit dhe të kenë iman tek Allahu.

Ibnul – Kajjim (Allahu e mëshiroftë) tha: *"Taghut është gjithçka për të cilën robi (i Allahut) kalon kufinjtë qoftë kjo dikush që adhurohet (veç Allahut), të cilit i bindet (në mosbindje ndaj Allahut), apo ndiqet (pasohet) (në mosbindje ndaj Allahut)."*

Taghutët janë shumë dhe kokat e tyre janë pesë:

(1) Iblisi – Mallkimi i Allahut qoftë mbi të.
(2) Kushdo që adhurohet dhe është i kënaqur me këtë adhurim që i ofrohet.
(3) Kushdo që i thërret njerëzit që të adhurojnë atë.
(4) Kushdo që pretendon se ka dije nga *Ghajb-i*.
(5) Kushdo që gjykon me tjetër nga ajo që ka shpallur Allahu.

Prova është thënia e Allahut të Lartësuar:

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنْ بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَى لَا انْفِصَامَ لَهَا وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

"Nuk ka asnjë detyrim në fe. Vërtet, Rruga e Drejtë është bërë e qartë nga rruga e gabuar. Kushdo që mohon Taghutin (çdo gjë tjetër që adhurohet përveç ose krahas Allahut) **dhe beson në Allahun, atëherë ai është kapur për mbajtësin më të sigurt që nuk thyhet kurrë. Dhe Allahu është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri."** (El Bekare:256)

Ky është edhe kuptimi i **"La ilahe il-laAllah" -** *(Askush nuk meriton, nuk ka të drejtë e nuk duhet të adhurohet përveç Allahut!)* Dhe në hadithin: *"Koka e çështjes është Islami. Shtylla e tij është Namazi dhe kulmi i tij është Xhihadi në rrugën e Allahut."*

E Allahu e di më mirë dhe paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi Muhammedin ﷺ, familjen e tij dhe Sahabët e tij.

(2009 – 10 -10 / Shaual 21, 1430)